

VENDIM
Nr. 840, datë 26.12.2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 509, DATË 30.8.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE TË POSAÇME TË LICENCIMIT DHE AUTORIZIMIT, DOKUMENTEVE SHOQËRUESE, QË PARAQITEN PËR PAJISJEN ME LICENCË APO AUTORIZIM, AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË LICENCËS DHE AUTORIZIMIT, PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT E TË VENDIMMARRJES DHE AFATEVE PËR KRYERJEN E TYRE, SI DHE PROCEDURAVE TË SHFUQIZIMIT/PEZULLIMIT TË LICENCAVE E AUTORIZIMEVE PËR PRODHIMIN, IMPORTIMIN, EKSPORTIMIN, TRANSITIMIN E ARTIKUJVE PIROTEKNIKË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 25, të ligjit nr. 73/2021, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pika 1, e nenit 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, për operatorin ekonomik, që kërkon të pajiset me licencë për import ose eksport të artikujve piroteknikë, vlerëson dokumentacionin e përcjellë nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, si më poshtë vijon:”.

Neni 2

Pika 1, e nenit 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, për operatorin ekonomik, që kërkon të pajiset me licencë për prodhimin e artikujve piroteknikë, vlerëson dokumentacionin e përcjellë nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, si më poshtë vijon:”.

Neni 3

Pika 1, e nenit 7, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, për operatorin ekonomik, që kërkon të pajiset me autorizim për import ose eksport të artikujve piroteknikë, vlerëson dokumentacionin e përcjellë nëpërmjet portalit “*e-Albania*” si më poshtë vijon:”.

Neni 4

Pika 1, e nenit 8, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, për operatorin ekonomik, që kërkon të pajiset me autorizim për transitin e artikujve piroteknikë, vlerëson dokumentacionin e përcjellë nëpërmjet portalit “*e-Albania*”, si më poshtë vijon:”.

Neni 5

Pas nenit 8 shtohet neni 8/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 8/1

Verifikimi i dokumentacionit

1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, në përputhje me përcaktimet e neneve 5, 6, 7 dhe 8, më sipër, verifikon nëpërmjet ndërveprimit institucional, me autorizim të kërkuarit, dokumentacionin si më poshtë vijon:

a) vërtetimin nga prokuroria që shoqëria, administratori, ortaku dhe punonjësit e angazhuar nuk janë në procedim penal;

b) vërtetimin që shoqëria dhe administratori nuk janë në proces gjyqësor penal, lëshuar nga gjykata e rrethit gjyqësor që ka selinë;

c) vërtetimin nga përmbartimi që shoqëria dhe administratori nuk kanë detyrime ndaj personave fizikë apo juridikë, privatë ose shtetërorë;

ç) certifikatën e gjendjes gjyqësore për administratorin, ortakun dhe punonjësit e angazhuar, të cilët nuk duhet të jenë të dënuar për vepra penale;

d) vërtetimin nga dega e tatimtaksave për shlyerjen e detyrimeve;

dh) vendimin për vlerësimin e ndikimit në mjedis, deklaratën mjedisore dhe lejen përkatëse mjedisore për prodhimin e artikujve piroteknikë;

e) lejen e ndërtimit për prodhimin e artikujve piroteknike;

ë) aktin teknik për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi për mjediset ku do të magazinohet dhe do të prodhohet artikulli piroteknik;

f) autorizimin për magazinimin e lëndëve plasëse, lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë;

g) certifikatën e trajnimit për drejtuesin teknik për kryerjen e kursit të trajnimit për zjarrfikës me rrezik të lartë pranë Akademisë së Sigurisë, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin;

gj) dëshminë e zjarrmëtarit për drejtuesin teknik, lëshuar nga autoriteti përgjegjës për çështjet minerare.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, të këtij neni, dokumentet e tjera sipas përcaktimeve të neneve 5, 6, 7 dhe 8, më sipër, paraqiten nga kërkuari.”.

Neni 6

Në nenin 11 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Operatori ekonomik paraqet përmes portalit “*e-Albania*” aplikimin *on-line* dhe dokumentacionin e kërkuar për t’u pajisur me autorizim me vulë elektronike për importin, eksportin, transitin e artikujve piroteknikë dhe licencë të importit, eksportit ose prodhimit.”.

2. Në pikën 2, pas fjalëve “...të plotësojë mangësitë e konstatuara...” shtohen “...nëpërmjet portalit “*e-Albania*”...”.

3. Në fjalinë e parë, të pikës 4, fjalët “...me shkresë...” zëvendësohen me “...nëpërmjet portalit “*e-Albania*”...”.

4. Në fjalinë e tretë, të pikës 4, fjalët “...me shkrim, nëpërmjet platformës *on-line*...” zëvendësohen me “...me dokument me vulë elektronike, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”...”.

Neni 7

Në pikat 1, 2 dhe 3, të nenit 12, fjalët “... me shkrim ose nëpërmjet platformave *on-line* ...” zëvendësohen me “... nëpërmjet portalit “*e-Albania*” ...”.

Neni 8

Në nenin 14 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikat 1 dhe 2, pas fjalëve “... pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve ...” shtohen “... nëpërmjet portalit “*e-Albania*” ...”.
2. Në shkronjën “a”, të pikës 4, pas fjalëve “... të njoftojë ...” shtohen “... nëpërmjet portalit “*e-Albania*” ...”.
3. Në shkronjën “b”, të pikës 4, pas fjalëve “... pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve ...” shtohen “... nëpërmjet portalit “*e-Albania*” ...”.

Neni 9

Në pikën 1, të nenit 16, pas fjalëve “...mund të ankimohen...” shtohen “...nëpërmjet portalit “*e-Albania*” ...”.

Neni 10

Dispozita kalimtare

Procedurat e parashikuara në vendimin nr. 509, datë 30.8.2023, të Këshillit të Ministrave, do të vijojnë të kryhen sipas mënyrës ekzistuese deri në momentin që përfundojnë zhvillimet teknike për pritjen e aplikimeve në sistemin e përmirësuar të menaxhimit të informacionit për AKSHE-në, për ofrimin e shërbimit nëpërmjet portalit “*e-Albania*”.

Neni 11

Organet zbatuese

Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama